

- FLETA E PASME E AUTORIZIMIT PER MAGAZINE FISKALE

Kuittë e autorizimit plotësohen si më poshtë:

1. Shënohet tipi i magazines fiskale: prodhimi/përpunimi ose stokimi,
Numer dalhuex psh....
Vendoset kodi fiskal specifik i magazinës sipas algoritmit përkatës.
2. Shënohet emri i shoqërisë, NIPT dhe adresa.
Vendoset kodi fiskal specifik i depozituesit të miratuar sipas algoritmit përkatës
3. Data dhe të dhënat referuese të kërkesës.
4. Zyra doganore kompetente për mbikqyrjen e magazines fiskale.
5. A dresen e plote të ambjenteve të magazines fiskale që do të përdoret për mallrat e vena nën regjim pezullimi.
6. Data në të cilën fillojnë efektet e autorizimit.
7. Vendin e saktë/adresën ku mbahet kontabiliteti i stokut dhe kontabiliteti financiar.
8. Shënohet periudha e vlerësuar/deklaruar gjatë të ciles kryhet një cikël prodhimi/përpunimi, apo periudha mesatare e stokimit.
9. Shënohen:
 - a) në rubrikën hyrje shënohet nga vijnë mallrat (import, blerje në tregun e brendshëm, etj)
 - b) në rubrikën dalje shënohet destinacioni i produkteve, mbetjeve etj., (eksport, riekспорт, hedhje në konsum, shkatërrim etj).
10. Shënohet, periodiciteti i afatit për dorezimin e inventareve
11. Shënohen, masa e garancisë, lloji i garancisë, menyra e llogaritjes, detajet mbi dokumentat garantuese.
12. Shënohen mallrat dhe Kodet respektive tarifore për:
 - a) Lëndët para të përdorura për prodhim, përpunim, përfshirë edhe produktet e akcizës që përdoren si lëndë e parë për prodhim produkti akcize.
 - b) Produktet e akcizës të stokuara/depozituara në rastin e magazinave fiskale të stokimit. c).Materiale ndihmëse të procesit të prodhimit, pullat fiskale, etiketat, etj.
13. Shënohet shkalla e lejuar e firove apo humbjeve. Në rastet kur nuk njihet, shpjegohet menyra e përcaktimit.
14. Shënohen produktet dhe kodet tarifore perkates të produkteve të akcizës të prodhuara. Në rastin e magazinave fiskale të stokimit mallrat dhe kodet respektive tarifore janë të njëjta mekutise 12.
15. Shënohen produkte të tjera, përveç atyre të akcizës, që dalin nga procesi i prodhimit apo përpunimit. Kjo kuti nuk plotësohet në rastin magazinave fiskale të stokimit.
16. Shënohen rastet kur mund të ketë zhvendosje të perkoshme mallrash.
17. Shënohen operacionet që do të kryhen në magazinën fiskale (psh., rafinim, distilim, stazhionim fermentim, etj).
18. Shënohen operacione shtese përveç atyre të parashikuara në kutinë 17, në varesi të tipit të magazines apo llojit të proceseve.
19. Shënohet baza ligjore e aplikueshme.
20. Vendosen shenime në lidhje me autorizimin në rast se shikohet e arsyeshme.
21. Shënohet numri i anekseve bashkëngjitur autorizimit nëse hapësira e kutive në autorizim është e parrjaftueshme